

Naim BERISHA

## VËSHTRIM ETNOLONGUISTIK MBI LEKSIKUN E TË FOLMES SË GRAVE NË RRAFSH TË DUKAGJINIT

Gjuha si sistem komunikimi është shprehëse e kulturës materiale e shpirtërore dhe si e tillë shërben për zhvillimin dhe funksionalizimin e marrëdhënieve shoqërore për kulturën e një vendi a të një kombi. Ndonëse nuk e ka objekt të parë të studimit, roli i gjuhës shfaqet edhe në etnografi, më konkretisht në krijimin e termave për të emërtuar koncepte, dukuri a marrëdhënie të kësaj fushe.

Duke u mbështetur në literaturën e shfrytëzuar, studimet në këtë fushë nuk mund të thuhet se janë shumë të hershme, ato filluan të zhvillohen në shekullin XX, me studimet e Boasit, të Sapirit etj. Në vend të termit *etnolinguistikë*, që gjen shtrirje më të madhe në ditët e sotme, studimet në këtë fushë i hasim të emërtuara edhe si *linguistikë antropologjike*, *metalinguistikë*, *mikrolinguistikë* etj.

Vështruar nga ky aspekt, etnokultura e një vendi ngërthen në vete shumë faktorë që gërshetohen njëkohësisht dhe e krijojnë identitetin kombëtar të atij vendi. Në realitetin tonë si popull, mënyra e banimit, e jetesës dhe doket e zakonet u japin shqiptarëve një fizionomi të veten ndër popujt e Ballkanit<sup>xi</sup>. “Në të gjitha krahinat shqiptare, në qytete dhe veçanërisht nëpër katunde, ndarja tradicionale e punës ka qenë njëherësh edhe njëfarë ndarje shoqërore e të folurit, e mënyrave të shprehjes, e pasurisë më të madhe (përkatesisht më të vogël) të një sfare terminologjike ndaj një tjetre edhe sipas seksit<sup>xi</sup>. Pra, në listën e ndarjeve shoqërore, duke filluar nga ajo kombëtare e deri tek ato fisnore e fetare, edhe ndarja sipas seksit është e një rëndësie të veçantë. Dallime të tilla janë në radhë të parë të lidhura me mendësinë, traditat dhe ndarjen e punës në familje, rolin e tyre në shoqëri, por edhe me temperamentin e karakterin gjithsesi të ndryshëm të meshkujve e të femrave të krijuar e të përshtatur sipas rrethanave jetësore.

Përveç dallimeve të përgjithshme që lidhen më së shumti me punën, me aktivitetin në shoqëri, në fis, në krahinë etj., dallimet midis burrave dhe grave shfaqen edhe në përdorimin e formave gjuhësore të mirësjelljes, këto si dallime gjuhësore të lidhura me zakonet, traditat, botëkuptimet etj. Një mënyrë e realizimit të kësaj ndarjeje është përdorimi i eufemizmave nga të dy gjinitë, përdorimi i urimeve, i mallkimeve që më shumë janë karakteristikë e të folurit të grave etj.

Vështruar në aspektin e etnokulturës në përgjithësi, por edhe hulumtimeve gjuhësore në këtë fushë, në Rrafsh të Dukagjinit nuk vërehen dallime të mëdha nga një e folme në tjetrën. “Nga aspekti etnografik Rrafshi i Dukagjinit është homogjen, si është homogjen edhe nga aspekti gjeografik<sup>xi</sup>. Ky homogjenitet është si pasojë e marrëdhënieve intensive në mes të viseve të ndryshme të këtij rajoni, të cilat mundësohen në radhë të parë nga shtrirja gjeografike e përshtatshme, por edhe kontakte të natyrave të ndryshme.

---

### Disa veçori leksikore të botës së grave

Sipas konceptit tradicional mbi të cilin është zhvilluar jetesa deri vonë, gratë janë marrë kryesisht me punët e shtëpisë. Veçori e punëve (e botës) të tyre është se ato mund të shoqëroheshin me biseda, por edhe këngë, çka është e kundërta për punët (botën) e burrave, të cilat kërkojnë përqendrim maksimal. E folura e grave karakterizohet me eufemizma të shumtë e të natyrave të ndryshme. Përveç eufemizmave që lidhen me doke e zakone të popullit në përgjithësi, një pjesë e tyre lidhen kryesisht me gruan dhe veprimtarinë e saj parësore (të përditshme), të cilat Eqrem Çabej i quan “eufemizma të një natyre thjesht sociale”. “Në krijimin e tyre shtysa nuk është frika, po më shumë një faktor psikik, ndjenja e turpit, kujdesi që me të folët tanë mos të lëndojmë ndjenjat e rrethit ku gjendemi, e ku hyjnë së pari e kryesisht fjalët e sferës seksuale”<sup>xi</sup>.

Gratë në njëfarë mënyre “ishin të përjashtuara” nga disa sfera të jetës, si punët e rënda fizike, punët me makinerinë e rëndë, punët bujqësore, deri diku edhe ato blegtorale. Ky “përjashtim” është reflektuar edhe në të folurit e tyre, por, krahas sferave të ndryshme të jetës, ato kanë qenë të përjashtuara edhe nga bisedat rreth seksit, që në njëfarë mënyre e kanë pasur të ndaluar. Kjo tematikë ishte në krye të listës së tabuve për gruan. Në vend të shprehjeve të drejtpërdrejta për proceset seksuale që burrat shpeshherë i përdornin pa hezitim të madh, kryesisht në rrethe meshkujsh por edhe në situata të nervozes, gratë pothuajse gjithmonë përdornin shprehje eufemistike, të tilla si: *fjeti me burr, e (n)dan shtratin, e bon at’ punen, e kryn at pune* etj. Ndërsa sa i përket emërimit të organeve gjenitale, gratë, pothuajse pa përjashtim, u shmangeshin emërtimeve të drejtpërdrejta. Për organin gjenital të meshkujve, femrat në shumicën e rasteve nuk e përmendnin fare, e kur përmendej, kryesisht përdorej shprehja *ai sendi*. Ardha e ciklit menstruaconal zakonisht përmendej si “*ardhja e teshave, m’kan ardh teshat, m’kan ardh ato, m’kan ardh*” etj. Kurse për organin gjenital të femrave, zakonisht përdoret *ai vendi/veni*, por edhe ndonjë shprehje tjetër.

Të gjitha ato që u thanë më sipër, kuptohet se nuk i përgjigjen realitetit të ditëve të sotme. Me ndonjë përjashtim të vogël sot, komunikimi gjuhësor i kësaj fushe zhvillohet duke përdorur emërtimet mjekësore *vaginë, penis, marrëdhënie seksuale* etj.

Ndonëse eufemizmat llogariten kryesisht si leksema tipike të grave, pak më ndryshe na paraqitet situata me gratë e moshuara (gjyshet), sidomos kur atyre u ka vdekur burri dha tashmë gëzonin autoritet të lartë që sigurohej nga djemtë. E folura e tyre karakterizohet me një liri në të shprehur, në fjalorin e tyre mund të haseshin edhe fjalë që për gratë ishin tabu. Nuk ngurronin të përmendnin emërtime edhe për pjesët intime dhe seksin në përgjithësi. Madje, roli i gjysheve në këto raste ishte si një lloj ndërmjetësuese në mes familjes dhe burrave, sidomos për fëmijët. Kur ndonjëri nga fëmijët përmendte fjalë të konsideruara “t’flliqtat” që për ta ishin të ndaluara dhe nuk duhet t’i përdornin, fëmija tjetër ankohej se ky ose ajo *po fol fjal’ t’ flliqtat*!, këtu vinte në shprehje roli dhe autoriteti i gjyshes. Nëse fëmija e kishte përmendur ndonjë pjesë intime të burrave apo grave, kishte situata kur ajo e qortonte (i bërtiste) duke i thënë *uuu ty t’dalt n’ ball...* Në rastet kur fëmija ishte djalë dhe e kishte përmendur vagjinën (kuptohet në variant lokal), ndodhte që gjyshja ta kapta djalin dhe të bënte sikur po e fuste në mes të këmbëve, duke i thënë *a po don p...*, krejt kjo në mënyrë

---

që ai të mos e përsëriste më gabimin. Për gjyshet në disa raste është karakteristikë edhe sharja, ato nuk hezitonin ta bënin këtë kur e kërkonte puna.

Shihet se personaliteti i gruas ishte i “kurdisur” në atë mënyrë që pothuajse të gjitha fjalët apo shprehjet që kanë kuptim sadopak të drejtpërdrejtë dhe që tregojnë ndonjë punë apo proces që lidhet me sferat që i përmendëm, të mos e përmend fare ose ta zëvendësojë atë me fjalë të tjera eufemistike.

Si më i ngarkuari me eufemizma është nëngrupi tematik i emërimit të sëmundjeve të ndryshme. “Në vend të emërimit të drejtpërdrejtë për disa sëmundje, gratë përdornin eufemizma, duke u nisur nga besimi se po të mos ia thonë emrin mund të largohet edhe vetë sëmundja, prandaj thonë *punëhera, puna e hënës, ajo e hënës, ajo e tokës, shkuma, e shkelura*, etj., në vend të epilepsia”<sup>xi</sup>. Në të folme të ndryshme në Rrafsh të Dukagjinit, për sëmundjen e kancerit që është e pashërueshme, gratë e përdorin *smuja e keqe*, emërtim eufemistik i cili përdorej edhe për ndonjë sëmundje tjetër që nuk shërohej. Shprehje tjetër eufemistike është *e paemna*, në vend të *i thati, i dalni*. Është i njohur përdorimi i eufemizmeve rreth vdekjes. Për të vdekurin përdorehin shprehje perifrastike që t’i shmangeshin përmendjes së tij, *i shkreti, i ziu, i ngrati (ngrati), i thami krish, i zezumi* etj.

Karakteristikë tjetër e të folurit të grave janë edhe mallkimet. Mallkimet janë të përhapura në të gjitha krahinat e shqiptare, kanë shkruar edhe shumë studiues të huaj si Edith Durham, Hahni e të tjerë, të cilët këtë gjini letrare gojore e shohin edhe si gjini e cila kryen aktin e gjykimit të këqijave dhe të keqbërësve, prandaj mallkimet shqiptare dallojnë nga ato ballkanike, që në përgjithësi kjo gjini letrare gojore është shumë e përhapur<sup>xi</sup>. Në fjalorin e grave hasen shprehje (mallkime, urime) shumë të fuqishme, si:

**Mallkime:** *T’dalt i dalni n’lul t’ballit!; T’ardh ka mos e pritsh!; E hongsh kryt ton!; Mos mujsh me dal as deri n’aborr; T’hiht dreçi n’bark; T’i çorroft Zoti syt!; Mos pafsh dit jara bi!; T’u mshelt dera me therr!; T’shkoft hisa hupt!*<sup>xi</sup>.

**Urime:** *Dalsh faqebadh’, T’u gzoft zemra, T’ardht e mira ka s’e pret, t’kapt e mira përqaft* etj.

Të folurit e grave karakterizohej edhe me diçka tjetër që lidhet me rrethanat dhe mendësinë popullore. Në të kaluarën, pothuajse përgjithësisht, me ndonjë përjashtim në zonat urbane, mënjanohej përmendja e emrit të burrit. Kur gruaja i drejtohej burrit, si formë më e përhapur ishte *ti njeri, njeri, o ti njeri*.

Gjuha e grave me të gjitha format e përdorimit që shfaqet, disa nga të cilat i përmendëm më lart, del si mënyrë e reflektimit të “ndershmërisë” së tyre të perceptuar nga shoqëria.

---

### **Bibliografia**

- A. Kostallari, *Vëzhgim mbi disa grupe fjalësh popullore të trojeve verilindore të shqipes*, në "Studime mbi leksikun...III, Tiranë 1989.
- E. Çabej, *Disa eufemizma të shqipes*, Studime gjuhësore IV, Prishtinë, 1987.
- E. Çabej, *Një vështrim mbi folklorin shqiptar*, Studime gjuhësore V, Prishtinë, 1988.
- G. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2009.
- L. Kadriu, *Kontributi etnolinguistik i Prof. Eqrem Çabejt*, Prishtinë, 2003.
- M. Iviq, *Drejtimit në linguistikë*, Prishtinë, 1977.
- M. Krasniqi, *Lugu i Baranit*, Prishtinë, 1985.
- N. Çoçaj, *Mallkimet dhe urimet, vëllimi VI, Hasi-enciklopedi kulturore*, Durrës 20011.